



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije,
Preduzetnistvo i Tergovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)

Me qëllim të promovimit të produkteve të bizneseve të grave ndërmarrëse dhe atyre me artizanate tradicionale, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpall:

Ftesë për pjesëmarrje në panairin “Gratë në Biznes” në Prishtinë

Panairi “Gratë në Biznes” do të organizohet nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përmes Agjencisë KIESA. Organizimi do të bëhet përmes kontraktimit të një operatori i ekonomik, i cili do të mbulojë shpenzimet e hapësirës ekspozuese (shtande), sigurimin fizik, pastrim ditor dhe çështjet tjera teknike rreth panairit.

MINT/KIESA nuk do të mbulojë shpenzimet operative të bizneseve/OJQ pjesëmarrëse në panair, përfshirë dërgimin/sjelljen e produkteve në panair, transportin dhe ushqimin e pjesëmarrëseve, etj. të cilat duhet të mbulohen nga vet pjesëmarrëset/it në këtë panair.

Panairi planifikohet të mbahet më datë 11, 12 dhe 13 korrik 2024, duke filluar nga ora 9:00 deri në ora 18.00, në sheshin Zahir Pajaziti, në Prishtinë.

Ftojme të gjitha bizneset e regjistruara / OJQ në Kosovë me pronare apo bashkëpronare të gjinisë femërore dhe atyre me artizanate tradicionale, që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në këtë panair.

Aplikimi bëhet duke plotësuar aplikacionin dhe se bashku me dokumentet e kërkuara me postë duhet të dërgojnë në formë fizike në Zyrën e arkivit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Lagjja e Spitalit, rr. “Arbënor e Astrit Dehari”, nr. 21, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës, më së largu deri më 31/05/2024 në ora 16:00, ose mund të i dërgojnë në formë elektronike në sme.kiesa@rks-gov.net

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e parapara në këtë thirrje.

Aplikacioni për aplikim mund të merret në KIESA-MINT apo të shkarkohet nga faqet e internetit mint.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net

Vëmendje:

- ✓ Në rast se bizneset aplikuese nuk janë në pronësi të gjinisë femërore apo bashkëpronësi me gjininë femërore, atëherë nuk i lejohet të marrë pjesë në panair.
- ✓ Vlerësimi i aplikacioneve bëhet ndërmjet kategorive.
- ✓ Numri maksimal i pjesëmarrëseve në panair do të jetë 40 shtande.

Dokumentet e nevojshme për aplikim, të cilat duhet të sjellën nga aplikuesit janë:

- Aplikacioni i plotësuar;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit apo OJQ-së;
- Kopja e letërnjoftimit të pronares/pronarit;
- Vërtetim tatimor që nuk ka borxhe ndaj ATK-së ose që ka marrëveshje për shlyerjen e tyre.

Kriteret e vlerësimit:

Në rast të konkurrencës, aplikuesit do të vlerësohen në mes veti në bazë të kriterëve në vijim, andaj nëse dokumentet në fjalë nuk dorëzohen, aplikuesit nuk do të diskualifikohen, por do të vlerësohen me zero pikë (nëse ka konkurrence për vlerësim), d.m.th. nëse tejkaloheh numri i planifikuar i shtandeve.

Dokumentet:

- Numri më i lartë i të punësuarve për vitin 2023 60%
 - Dëshmi mbi numrin e të punësuarve nga ATK-a për vitin 2023;
- Qarkullimi më i lartë vjetor për vitin 2023 30%
 - Dëshmi mbi qarkullimin vjetor nga ATK-ja për vitin 2023;
- Eksporti (vlera më e lartë e eksportit 2023) 10%
 - Dëshmi mbi eksportin nga Dogana e Kosovës për vitin 2023 (nëse ka).